



BASHKIA
TIRANË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 86, datë 26.07.2017

PËR

“SHPREHJEN E PËLQIMIT PËR DHËNIEN ME QIRA PA KONKURRIM NË FAVOR TË “TIRANA PARKING” PËR PASURINË ME NUMËR 5/626; 5/102; 5/251 DHE ZK. NR. 8160, TRUALL ME SIPËRFAQE TOTALE 6 000 m² NË PRONËSI TË SHTETIT DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË ADMINISTRIM TË “REZIDENCËS STUDENTORE NR. 1” SHA, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja (b) dhe pika 1/1.2, nenit 25, nenit 54, shkronja (e), nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; vendimit nr. 335, datë 04.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1” SHA Tiranë, “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” SHA, Tiranë dhe “Trajtimi i Studentëve Nr. 3” SHA, Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia Tiranë”, vendimit nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, vendimit nr. 6, datë 20.07.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Qendrës Studentore Universitare nr.1 sha, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të japë pëlqimin për dhënie me qira pa konkurrim në favor të “Tirana Parking” të objektit truall, për pasurinë me numër 5/626; 5/102; 5/251 dhe ZK 8160, me sipërfaqe totale 6 000 m² (gjashtëmijë), në pronësi të Shtetit dhe të Republikës së Shqipërisë, në administrim të Rezidencës Studentore nr. 1” Sh.a, Tiranë, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Afati i dhënies me qira është për 10 vjet.
3. Ky proces të kryhet sipas përcaktimeve të Kreut I, pika 5, shkronja (d) të vendimit nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.

4. “Tirana Parking” të përdorë pasuritë e mësipërme për ushtrimin e detyrave të saj institucionale dhe funksionale, të përcaktuara sipas akteve nënligjore të krijimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e procedurave të mëtejshme dhe përcjelljen e dosjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si përfaqësues i pronarit të pronës publike, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI